

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi e Burim Shala – anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses – të kundërpaditurës M.M. nga fshati ... komuna e Vitisë, të cilën përmes Zyrës për Ndhimë Juridike Falas e përfaqëson i autorizuari i saj av.A.I. nga Vitia, kundër të paditurit – kundërpaditësit K.M. nga fshati ... komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.E.P. nga Vitia, për shkak të besimit të fëmijëve të mitur si dhe pagesës së alimentacionit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses – të kundërpaditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti C.nr.76/18, të datës 20.08.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 08.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e paditëses – të kundërpaditurës M.M. nga fshati ... komuna e Vitisë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti C.nr.76/18, i datës 20.08.2018, në pikën II dhe IV të dispozitivit të tij dhe i njëjti gjykohet si në vijim:

II. DETYROHET i padituri – kundërpaditësi K.M. nga fshati ... komuna e Vitisë, që në emër të alimentacionit për fëmijët e tij të mitur F.M., i lindur më 30.05.2010 dhe D.M., i lindur më 12.11.2014, në Gjilan, t'ia paguaj paditëses – të kundërpaditurës M.M. shumën në lartësi prej 100 euro për secilin prej tyre, përkatësisht shumën e tërësishme prej 200 euro në muaj dhe atë nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 20.08.2018, e tutje, me kamatë ligjore 8%, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 20.08.2018, e deri në pagesën definitive, e cila pagesë do të bëhet për çdo muaj, e më se largu deri me datën 5 të secilit muaj vijues (për muajin paraprak), me ç'rast pagesa do t'i bëhet personalisht paditëses – të kundërpaditurës në xhirollogarinë e saj, apo në çfarëdo mënyre tjetër të përshtatshme, krejt kjo deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, apo ky vendim në këtë pjesë të mos ndryshohet, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Pjesa tjetër e kërkespadsisë së paditëses – të kundërpaditurës nga shuma e aprovuar sikurse në pikën II të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar prej 300 euro, **refuzohet si e pabazuar**.

III. APROVOHET ankesa e të paditëses – të kundërpaditurës M.M., në lidhje me pikën III të aktgjykimit të atakuar, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti C.nr.76/18, i datës 20.08.2018, në pikën III të dispozitivit të tij dhe i njëjti gjykohet si në vijim:

Detyrohet paditësja – e kundërpaditura M.M. që t’ia mundësoj të paditurit – kundërpaditësit K.M. kontaktin me fëmijët e tij të mitur F.M. dhe D.M., dy herë në muaj dhe atë të hënën e parë dhe të tretë të muajit, nga ora 10 e deri në orën 12, i cili kontakt do të realizohet në lokalet e Qendrës për Punë Sociale në Gjilan, përveç nëse palët me vullnet të tyre merren vesh ndryshe për vendin e pranim dorëzimit të fëmijëve me ç’rast pranimi dorëzimi i fëmijëve do të bëhet personalisht nga ana e këtu palëve ndërgjyqëse. Po ashtu detyrohet paditësja – e kundërpaditura që t’ia mundësoj të paditurit -kundërpaditësit kontaktin me fëmijët e mitur F.M. dhe D.M. edhe ditën e dytë të festave shtetërore dhe fetare si dhe gjatë pushimeve vjetore nga 3 ditë të pushimit, kurse me rastin e ditëlindjes së fëmijëve të mitur, ditën e nesërme pas ditëlindjes së secilit prej tyre ata do ta festojnë me të atin. Kjo mënyrë e kontaktimit të vazhdojë edhe në vitet në vijim, deri sa deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, apo ky vendim në këtë pjesë të mos ndryshohet.

IV. Në pikën I, V dhe VI të tij, aktgjykimi në fjalë i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti C.nr.76/18, i datës 20.08.2018, mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.76/18, të datës 20.08.2018, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që ta aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses – të kundërpaditurës M.M., ashtu që fëmijët e mitur të palëve ndërgjyqëse F.M., i lindur më 30.05.2010 dhe D.M., i lindur më 12.11.2014, i janë besuar në ruajtje, kujdes dhe edukim nënës, këtu paditëses – të kundërpaditurës M.M.. Në pikën II të dispozitivit është detyruar i padituri – kundërpaditësi K.M. që në emër të mbajtjes së fëmijëve (ushqimisë) për fëmijët e mitur F.M. dhe D.M., të paguaj shumën prej 90 euro dhe 70 euro respektivisht, e cila pagesë do të bëhet me datën 05 të muajit vijues, duke cekur se kjo pagesë fillon të rrjedh nga data 20.02.2018 dhe zgjatë derisa të ekzistojnë kushtet ligjore. Në pikën III të dispozitivit është detyruar paditësja – e kundërpaditura M.M. që t’ia mundësoj të paditurit – kundërpaditësit K.M. kontaktin me fëmijët e tyre të mitur F.M. dhe D.M. dy herë në muaj dhe atë të hënën e parë dhe të tretë të muajit, duke filluar nga ora 10 e deri në orën 12, i cili kontakt do të realizohet në zyrat e Qendrës për Punë Sociale në Viti. Në pikën IV të dispozitivit, pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses – të kundërpaditurës M.M. e cila ka të bëjë me pagesën e alimentacionit për fëmijët e mitur, nga shuma e aprovuar prej 160 euro e deri në shumën e kërkuar prej 300 euro, e ka refuzuar si të pabazuar. Në pikën V të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëkundërpadinë e të paditurit – kundërpaditësit K.M., të parashtruar në seancën e datës 02.07.2018, me të cilën ka kërkuar që fëmijët e mitur t’i besohen atij në ruajtje, kujdes dhe edukim, ndërsa kontakti me paditësen – të kundërpaditurën të realizohet sipas marrveshjes së palëve. Në pikën VI të dispozitivit është detyruar i padituri – kundërpaditësi që në emër të shpenzimeve procedurale, t’i paguaj në xhirollogarinë e Zyrës për Ndhmë Juridike Falas në Gjilan, shumën prej 250 euro, brenda afatit prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësja – e kundërpaditura përmes të autorizuarit të saj në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si tërësisht të bazuar, aktgjykimin ta prishë dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje, por vetëm sa i përket pikës (II) III dhe IV të këtij aktgjykimi, ndërsa pjesa tjetër të mbetet e pa ndryshuar.

I padituri – kundërpaditësi nuk ka parashtruar as ankesë, e as përgjigje në ankesën e paditëses – të kundërpaditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses – të kundërpaditurës është pjesërisht e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja – e kundërpaditura M.M., me datën 20.02.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurit – kundërpaditësit K.M., për shkak të besimit, ruajtjes dhe kujdesit të fëmijëve të mitur dhe pagesës së alimentacionit, me arsye sikurse në padi. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht në seancën e fundit të datës 20.08.2018, paditësja – e kundërpaditura përmes të autorizuarit të tij e ka precizuar kërkespadinë e saj në kuptim të shumës së kërkuar në emër të alimentacionit, duke kërkuar nga 150 euro për secilin nga fëmijët e tyre të mitur, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 20.08.2018

Në seancën përgatitore të datës 02.07.2018, i padituri – kundërpaditësi K.M. përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar kundërpadi kundër paditëses – të kundërpaditurës M.M., me të cilën ka kërkuar që fëmijët e mitur të palëve ndërgjyqëse t'i besohen në ruajtje dhe kujdes të paditurit – kundërpaditësit si baba i tyre biologjik, që kontakti me nënën e fëmijt të jetë sipas marrëveshjes së lirë të tyre, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 02.07.2018.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, si dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, e ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.76/18, të datës 20.08.2018, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses – të kundërpaditurës si të bazuar, duke vendosur më saktësisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësja – e kundërpaditura M.M. me të paditurin – kundërpaditësin K.M. kanë krijuar bashkësi jashtëmartesore nga viti 2008 e deri në fund të vitit 2017. Gjithashtu nuk është kontestues as fakti se përgjatë kësaj kohe këtu palëve ndërgjyqëse u kanë lindur dy fëmijët e mitur F.M. dhe D.M.. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se fakt kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse është paraqitur të jetë se cilit prej tyre si prindër t'iu besohen në ruajtje, kujdes dhe edukim fëmijët e tyre të përbashkët të lindur në bashkësinë jashtëmartesore. Gjithashtu fakt kontestues nga i padituri – kundërpaditësi K.M. është paraqitur edhe kërkesa e paditëses – të kundërpaditurës M.M. për pagimin e alimentacionit për fëmijët e tyre të mitur. Në këtë drejtim gjykata kishte angazhuar Qendrën për Punë

Sociale (QPS) në Gjilan dhe mbi bazën e raportit të kësaj të fundit kishte vendosur që fëmijët e mitur të palëve ndërgjyqëse t'ia besoj në ruajtje kujdes dhe edukim nënës së tyre, përkatësisht këtu paditëses – të kundërpaditurës M.M., në ndërkohë që kontakti i të paditurit – kundërpaditësit me fëmijët e tyre të mitur të jetë sikurse në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar. Po ashtu ishte vendosur edhe për pagesën e alimentacionit në emër të fëmijëve të mitur dhe atë në shumën e përgjithshme prej 160 euro në muaj, më saktësisht sikurse në pikën II të aktgjykimit të atakuar. Mbi bazën e të lartcekurave e duke u bazuar në dispozitat e nenit 290 paragrafi 1, lidhur me nenin 142.1 dhe 145 të Ligjit për Familjen të Kosovës (LFK), gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Lidhur me shpenzimet procedurale, e njëjta vendimin e saj e ka mbështetur në dispozitën e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale në rastin në fjalë është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pjesën e pa sulmuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Sipas nenit 139 par.2 të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK), është paraparë se *“nëse në rastin e jetës së ndarë, prindërit nuk merren vesh se me cilin prej tyre do të jetojë fëmija, vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente...”*. Ndërsa me nenin 144 par.1 të LFK-së është paraparë se *“Gjykata ose Organi i Kujdestarisë, i cili e merr vendimin mbi besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme t'i hetojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës”*. Po ashtu, me nenin 145 par.1 të LFK-së, decidivisht është cekur se *“nëse fëmija jeton vetëm me njërin prind ose me personin e tretë ose në institucion, prindërit do të merren vesh për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën. Në rast të kontestit, vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente”*.

Në rastin konkret, sipas Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur që fëmijët e mitur t'ia besohen në ruajtje, kujdes dhe edukim nënës së tyre – këtu paditëses – të kundërpaditurës M.M. si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, duke pasur parasysh moshën e tani të miturve, interesin e tyre për shkak të lidhjes emocionale me nënën, lidhje kjo që ndikon drejt në zhvillimin psikik dhe fizik të fëmijës, si dhe edukimin e tyre, rekomandim ky i dhënë edhe nga ana e QPS në Gjilan, të cilës gjykata e shkallës së parë i'a kishte falur besimin e plotë. Është bindje edhe e Gjykatës së Apelit se përkundër që kjo pjesë e aktgjykimit nuk është atakuar, tani për tani interesi më i mirë i fëmijëve të mitur F.M. dhe D.M., është që ushtrimi i kujdesit prindëror t'ia besohet nënës së tyre, përkatësisht

këtu paditëses – kundërpaditurës, pasi që i padituri – kundërpaditësi tanimë ka krijuar bashkësi të re faktike martesore me një persone tjetër.

Me dispozitën e nenit 90 paragrafi 1, i LFK-së, është përcaktuar se “*prindërit janë të detyruar t’i ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur*”, kurse me dispozitat e nenit 330.1 dhe 2 të LFK-së, përcaktohet se “*a) detyrimi për të dhënë mbajtje financiare përcaktohet në proporcion me të gjitha mjetet e të paditurit dhe brenda kufijve të nevojave të paditësit, b) gjykata duhet të këtë parasysht gjendjen financiare të paditurit, aftësitë për të punuar, mundësit faktike për punësim, kushtet shëndetësore, nevojat personale, detyrimet ligjore dhe të gjitha kushtet e tjera relevante*”. Në këtë kuptim kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka vendosur sikurse në dispozitivin II dhe IV të aktgjykimit të atakuar sepse pavarësisht arsyeve dhe shkaqeve ekonomike eventuale, prindërit së bashku janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijën e tyre të përbashkët, duke marrë për bazë gjendjen financiare të bashkëshortit apo prindit tjetër dhe të gjitha rrethanat tjera që duhet të merren për bazë për caktimin e lartësisë së ushqimisë e veçanërisht mundësinë e dhënësit të mbajtjes financiare dhe moshën e fëmijëve, si dhe nevojat e domosdoshme për edukimin dhe arsimimin e tyre. Gjykata ka vlerësuar se detyrimi i të paditurit – kundërpaditësit për të paguar mbajtje – ushqimi për dy fëmijët e mitur në lartësi prej 200 euro, nuk do të ishte një detyrim që e vë në pikëpyetje ekzistencën dhe mirëqenien e tij, pavarësisht faktit se i njëjti në ndërkohë ka krijuar bashkësi të re martesore faktike me personën tjetër dhe faktit se i njëjti për momentin nuk gëzon ndonjë punë të rregullt duke qenë tregtar i automobilave dhe duke realizuar fitim prej rreth 500 euro në muaj, pasi që kjo është gjendja momentale e tij, por nuk do të thotë se kjo gjendje nuk mund të përmirësohet përdërisa i njëjti gëzon shëndet dhe është i aftë për punë. Meqenëse paditësja – kundërpaditura jeton me prindërit e saj, duke mos punuar dhe mos realizuar asnjë të ardhur, kjo rrethanë vetëm sa e rrit më tepër detyrimin e të paditurit – kundërpaditësit që të merr përgjegjësi për rritjen dhe edukimin sa më të shëndosh të fëmijëve të tyre të mitur F.M. dhe D.M., për çka edhe është bindje e kësaj gjykate se në këtë rast gjykata e shkallës së parë, nuk kishte vlerësuar drejt kur ka vendosur për ta aprovuar shumën prej 160 euro në emër të ushqimisë së fëmijëve të mitur. Mbi këtë bazë e duke e pasur parasysht rrethanat e cekura me lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkatësisht e ndryshoj atë sa i përket shumës së alimentacionit për fëmijët e mitur, duke gjetur se në këtë pjesë qendrojnë pretendimet ankimore të të paditurës - kundërpaditëses. Kjo nuk do të thotë se në të ardhmen palët me ndryshimin e rrethanave nuk mund të kërkojnë ndryshimin e vendimit sa i përket mbajtjes financiare të fëmijës, kujdesin prindëror dhe caktimin ndryshe të kontakteve të prindërve me fëmijën, pasi që ata në çdo kohë mund të kërkojnë ndryshimin e vendimit me kusht që të vërtetojnë ndryshimin e rrethanave që kanë ekzistuar me rastin e caktimit të mbajtjes financiare, për kujdesin prindëror, caktimin e kontakteve të prindërve me fëmijën, apo dhe për pagesën e alimentacionit.

Gjykata e Apelit gjithashtu e ka aprovuar si të bazuar pjesërisht ankesën edhe në lidhje me pikën VI të aktgjykimit të atakuar që ka të bëjë me kontaktin e fëmijëve të mitur me të atin e tyre biologjik, këtu të paditurin - kundërpaditësin, duke gjetur se qendrojnë pretendimet ankimore të paditëses - të kundërpaditurës të paraqitura përmes të autorizuarit të

saj, sa i përket vendit ku do të realizohet kontakti i tyre me të atin e tyre këtu të paditurin – kundërpaditësin K.M., ngase përderisa babai i paditëses – të kundërpaditurës punon në QPS në Viti, realizimi i kontaktit në këtë qendër mund të interpretohet si konflikt interesi. Kurse sa i përket mënyrës së realizimit të kontaktit sikurse në pikën III të këtij aktgjykimi, gjykata gjeti se mënyra e vendosjes për rregullimin e kontaktit nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk ka qenë e plotë sepse pavarësisht faktit se cilit prind i besohen fëmijët e mitur, përderisa e drejta prinëdore nuk i është hequr prindit tjetër edhe ai prind ka të drejtë që të takohet dhe t'i realizoj kontaktet me fëmijët e tij të mitur. Andaj në këtë drejtim, Gjykata e Apelit vendosi sikurse në dispozitivin III të këtij aktgjykimi, duke e rregulluar kontaktin e të paditurit – kundërpaditësit K.M. në mënyrë detale me fëmijët e tij të mitur, si një e drejtë e tij, por edhe e drejtë e fëmijëve, e garantuar edhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara e cila Konventë zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Megjenëse pikat I, II dhe V të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar nuk kanë qenë të atakuara me ankesën e paditëses – të kundërpaditurës, në ndërkohë që as nga i padituri – kundërpaditësi nuk ka pasur ankesë, gjykata aktgjykimin në fjalë në këto pjesë, nuk e ka shqyrtuar.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika b) dhe d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4395/18, me datën 08.11.2018

Kryetari i kolegjit – Gjyqtari
Valon Totaj